



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 36 datë 07.05.2026

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES DHE TARIFAVE PËR PËRDORIMIT DHE
DHËNIEN ME QIRA TË BIÇIKLETAVE ELEKTRIKE NË MBËSHTETJE TË
TURIZMIT, BASHKIA PËRMET

Këshilli Bashkiak Përmet i mbledhur më datën: 07/05/2026, në mbështetje të: Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Vendim nr.153, datë 7.4.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Akteve nënligjore në fuqi për sigurinë rrugore dhe transportin, Ligj nr 68/2017 “Për Financat e Vetqeverisjes Vendore” i ndryshuar, Ligj nr 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, Marrëveshjes së bashkëpunimit nr 1785/1 datë 13.06.2025 midis Bashkisë Përmet dhe FSHZH në kuadër të projektit “Pajisje për mbështetjen e shërbimeve bashkiake për përmirësimin e menaxhimit të trafikut”, Akt dorëzimit nr. 2228 datë: 09.07.2025 të 25 (njëzet e pesë) cop biçikleta elektrike (bicycle+charger) sipas dokumentacionit shoqëruar të tyre , pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga komisioni Drejtoria Juridike, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Buqësisë, Turizmit, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, dhe me propozim të Kryetari të Bashkisë,

VENDOSI:

- 1- Të miratojë rregulloren dhe tarifat për funksionimin e biçikletave elektrike në Bashkinë Përmet sipas dokumentit bashkëlidhur dhe është pjesë përbërëse e tij.
- 2- Të miratojë kontratën e përdorimit tip për dhënie me qira të biçikletave elektrike në Bashkinë Përmet sipas Aneksit 1 bashkëlidhur rregullores dhe është pjesë përbërëse e tij.
- 3- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Buqësisë, Turizmit, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Sektori i aktiviteteve kinema-muze, Zyra e financës në Bashki.
- 4- Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, (i ndryshuar).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

RREGULLORE
E PËRDORIMIT TË BIÇIKLETAVE ELEKTRIKE NË MBËSHTETJE TË TURIZMIT,
BASHKIA PËRMET.

Në mbështetje të: Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Vendim nr.153, datë 7.4.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të kodit rrugor të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Akteve nënligjore në fuqi për sigurinë rrugore dhe transportin, Ligj nr 68/2017 “Për Financat e Vetqeverisjes Vendore” i ndryshuar, Ligj nr 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar; miratohet kjo rregullore:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i kësaj rregullore

Kjo rregullore përcakton rregullat për përdorimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e biçikletave elektrike në mbështetje të turizmit në Bashkinë Përmet, me qëllim garantimin e sigurisë rrugore dhe mbrojtjen e përdoruesve.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet për: subjektet/entet publike që administrojnë flotën dhe ofron shërbimin e dhënies me qira të biçikletave elektrike; përdoruesit individualë; ose çdo person që administrojnë ose përdorin këto mjete në territorin e Bashkisë Përmet.

Neni 3

Përkufizime

“**Biçikletë (e-bike)**” – mjet me dy rrota, i pajisur me motor elektrik ndihmës, ku fuqia ndërpritet kur ndalohet pedalimi dhe që nuk kalon shpejtësinë 25 km/h, ose mjet me pedale me motor elektrik me shpejtësi më të vogël se 45 km/h.

“**Përdorues**” – personi fizik që përdor biçikletën.

“**Operator**” – subjekti/enti që administrojnë flotën ose shërbimin e biçikletave elektrike.

KREU II
KUSHTET E PËRDORIMIT

Neni 4

Kriteret për përdoruesit

1. Dhënia me qira e këtyre mjeteve mund të kryhet vetëm për personat e pajisur minimalisht me Lejedrejtimi L1 për mjete të kategorisë AM, parashikuar në Kodin Rrugor të Republikës së

- Shqipërisë, modelit të Bashkimit Europian, ose leje drejtimi ekuivalente e shteteve të huaja, e njohur në Republikën e Shqipërisë.
2. Përdoruesi i këtyre mjeteve duhet tu përmbahet të gjitha nomave të parashikuara nga Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë, akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe akteve rregulluese të miratuara nga Bashkia Përmet mbi qarkullimin rrugor.
 3. Përdorimi lejohet për persona mbi 18 vjeç.
 4. Përdoruesi duhet të jetë i aftë fizikisht dhe mendërisht.
 5. Ndalohet përdorimi nën ndikimin e alkoolit ose substancave narkotike.
 6. Këto mjete nuk mund të qarkullojnë në korsitë e dedikuara për biçikleta. Në zonat me trafik të kufizuar, lëvizja duhet të kryhet ekskluzivisht vetëm me pedale.
 7. Në rast të qarkullimit në rrugë në zonat urbane, gjatë kohës së pedalimit të asistuar ose lëvizjes tërësisht me anë të motorrit elektrik, shpejtësia e lejuar nuk duhet të kalojë 25km/orë. Lëvizja në këto raste duhet të kryhet nën kufizimin automatik sipas tarimit të fabrikës, në parametrin P08.
 8. Qiramarrësi nuk mund ta japë mjetin e marrë me qira për të tretë në asnjë rrethanë.
 9. Qiramarrësi në asnjë mënyrë nuk mund të ndryshojë apo modifikojë mjetin.
 10. Në mjetet e marra me qira nuk mund të udhëtojnë më shumë se një person.
 11. Mjetet nuk mund të përdoren për transport mallrash përveç sa parashikuar në Kodin Rrugor apo aktet në mbështetje të tij për mjetet me pedale me karakteristika konstruktive të ngjashme.
 12. Të mos bëjë shmangie të papritura ose lëvizje zigzage që mund të bëhen pengesë ose rrezik për mjetet që vijnë pas.
 13. Kur afrohen në degëzime e kryqëzime, duhet të respektojnë sistemin e sinjalizimit rrugor, të zvogëlojnë shpejtësinë deri në ndalim të plotë dhe të marrin masa për t'i kaluar ato pa rrezik.
 14. Përdoruesi i mjetit duhet tu përmbahet rigorozisht instruksioneve të parashikuara në Aneksin 1.

Neni 5
Rregullat e qarkullimit

1. Biçikletat elektrike qarkullojnë në përputhje me rregullat e Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë.
2. Përdorimi bëhet në:
 - o pista biçikletash të dedikuara, kur ekzistojnë;
 - o rrugë urbane ku lejohet qarkullimi i tyre.
3. Shpejtësia maksimale nuk duhet të tejkalojë 25 km/h.
4. Përdoruesi duhet të respektojë sinjalistikën rrugore.

KREU III
SIGURIA DHE PAJISJET

Neni 6
Kërkesat teknike

Biçikleta elektrike duhet të jetë e pajisur me:

- sistem frenimi funksional;
- drita përpara dhe prapa;
- elementë reflektues;
- sinjal paralajmërues (zile).

Neni 7
Masat e sigurisë

1. Përdorimi i kaskës mbrojtëse rekomandohet fuqimisht. Gjithmonë mbani kaskën kur ngasni biçikletën
2. Gjatë natës ose në kushte të dobëta ndriçimi, përdorimi i dritave është i detyrueshëm.

3. Ndalohet përdorimi i telefonit gjatë drejtimit, përveçse me pajisje hands-free.

KREU IV
ADMINISTRIMI DHE MIRËMBAJTJA
Neni 8
Detyrimet e operatorit/entit

Operatori/enti publik është i detyruar:

1. Të sigurojë mirëmbajtjen periodike të biçikletave;
2. Të garantojë funksionimin teknik dhe sigurinë;
3. Të pajisë biçikletat me elementët e nevojshëm të identifikimit.
4. Të kryejë pastrimim e bicikletave

Neni 9
Përdorimi i baterisë

1. Karikimi kryhet vetëm me pajisje të certifikuara.
2. Ndalohet ndërhyrja në sistemin elektrik.
3. Bateritë duhet të ruhen në kushte të sigurta.

KREU V
PËRGJEGJËSITË DHE MASAT
Neni 10
Përgjegjësitë

1. Përdoruesi mban përgjegjësi për shkeljet e rregullave dhe dëmet e shkaktuara ndaj të tretëve.
2. Operatori/enti publik mban përgjegjësi për sigurinë teknike të mjetit deri në momentin e dorëzimit.

Neni 11
Masat administrative

Në rast shkeljeje zbatohen:

- masa administrative sipas legjislacionit në fuqi;
- kufizim ose ndalim i përdorimit;
- gjoja, sipas akteve përkatëse.

KREU VI
TARIFAT DHE PAGESAT
Neni 12
Parimet e tarifimit

1. Shërbimi i biçikletave elektrike ofrohet kundrejt pagesës.
2. Tarifat duhet të jenë transparente, të publikuara dhe të aksesueshme për përdoruesit.
3. Paga kryhet përmes aplikacioneve digjitale, kartave bankare ose mënyrave të tjera të miratuara.

Neni 13
Struktura e tarifave

Tarifat mund të përfshijnë:

1. **Tarifë aktivizimi** (fillimi i udhëtimit)
2. **Tarifë për minutë/orë/ditë përdorimi**
3. **Tarifë: Ditore**
4. **Tarifa penalizuese në rast:**

- vonese në kthim: - 300 lek/orë vonese
- dëmtimi të mjetit: - 20 % e vlerës së mjetit.
- dëmtimi gomave të mjetit: - 5 000 lek/gomë
- dëmtimi i frenave të mjetit: - 3 000 lek.
- dëmtimi të tjera të mjetit: - 5 % vlerës së mjetit.



Neni 14

Procedura dhe mënyra e pagesës

1. Pagesa për përdorimin e biçikletave elektrike kryhet përpara marrjes në përdorim të tyre, në përputhje me tarifën e miratuara në Nenin 15 të kësaj Rregulloreje.
2. Pagesa realizohet sipas një prej formave të mëposhtme:

a) Pagesa pranë sportelit fizik

Personat e interesuar paraqiten pranë sportelit të Zyrës së Informacionit Turistik, me adresë pranë Qendrës Multifunktionale Përmet, ku bëhet regjistrimi i kërkesës dhe sipas kërkesës lëshohet fatura tatimore përkatëse, pagesa e së cilës kryhet pranë një banke të nivelit të dytë ose pranë degës së Postës Shqiptare, sipas të dhënave të faturës së lëshuar.

b) Pagesa online

Personat e interesuar mund të rezervojnë dhe të kryejnë pagesën në mënyrë elektronike nëpërmjet opsionit “payment link” të publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Përmet www.bashkiapermet.gov.al. Konfirmimi elektronik i pagesës përbën provë të vlefshme për përfitimin e shërbimit.

3. Dorëzimi për përdorim i biçikletës elektrike kryhet vetëm pas verifikimit të kryerjes së pagesës, sipas një prej formave të përcaktuara në këtë nen.
4. Dokumentacioni që vërteton pagesën ruhet dhe administrohet nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë Përmet, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 15

Niveli orientues i tarifave

Nr	Koha e përdorimit	Çmimi mesatar Lek	Përshkrimi
1	0 - 1 orë	200	Ideale për xhiro të shpejta
2	0 - 2 orë	300	Për lëvizje të shpejtë në qytet
3	2 - 4 orë	500	Shëtitje e shkurtër turistike
4	4 - 6 orë	800	Vizitë në disa pika turistike
5	6 - 8 ore	1,000	Gjysmë dite eksplorim
6	8- 12 orë	1,500	Paketë turistike
7	24 orë	2,000	Eksplorim më i gjatë turistik
8	3 ditë	3,000	Paketë turistike e plote


Operatori/enti ka të drejtë të ndryshojë tarifën me njoftim paraprak.

KREU VII

KONTRATA E PËRDORIMIT/MARRVESHJES

Neni 16

Lidhja e kontratës/marrveshjes



1. Kontrata/marrveshja ndërmjet përdoruesit dhe operatorit lidhet drejtpërdrejtë ose në mënyrë elektronike përmes aplikacionit ose platformës online nëse është e mundur.
2. Me pranimin e kushteve, përdoruesi konsiderohet i informuar dhe dakord me rregulloren.



Neni 17 Të drejtat e përdoruesit

Përdoruesi ka të drejtë:

- Përpara marrjes në dorëzim nga ana e përdoruesit kryhet kontrolli për mirëfunksionimin dhe sigurinë sipas Aneksit 1 të kësaj rregulloreje.
- të përdorë një mjet funksional dhe të sigurt;
- të informohet për tarifat dhe kushtet;
- të raportojë probleme teknike;
- të ndërpresë përdorimin në çdo kohë.

Neni 18 Detyrimet e përdoruesit

Përdoruesi detyrohet:

1. Të përdorë biçikletën sipas Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë;
2. Të mos dëmtojë apo modifikojë mjetin;
3. Të sigurohet për gjendjen teknike të mjetit në momentin e dorëzimit sipas Aneksit 1
4. Të respektojë zonat e lejuara të parkimit;
5. Çiklisti është i detyruar të drejtojë automjetin në mënyrë që nuk zvogëlon qëndrueshmërinë e mjetit dhe nuk duhet t'i heq duart nga timoni, dhe nuk duhet të mbahet në një mjet tjetër.
6. Përdoruesi nuk duhet të ketë kafshë me vete derisa e drejton biçikletën.
7. Në marrjen në dorëzim pas përdorimit, kryhet kontrolli për dëme. Në rast të konstatimit të dëmeve për faj të përdoruesit, këto i vihen në ngarkim për dëmshpërblim qiramarrësit.
8. Të paguajë çdo tarifë dhe penalitet të aplikueshëm.

Neni 19 Përgjegjësia për dëmet

1. Përdoruesi mban përgjegjësi për çdo dëmtim të shkaktuar nga përdorimi i pakujdesshëm, zbatohet Neni 13 i kësaj rregulloreje.
2. Në rast vjedhjeje ose humbjeje, përdoruesi është i detyruar të njoftojë menjëherë operatorin dhe autoritetet.
3. Operatori/enti mund të aplikojë penalitete financiare sipas dëmit të shkaktuar. zbatohet Neni 13 i kësaj rregulloreje.

Neni 20 Kufizimi i përgjegjësisë së operatorit/entit

Operatori nuk mban përgjegjësi për dëmet e shkatuara përdoruesit gjatë përdorimit të bicikletave.

- dëmet që vijnë nga përdorimi i gabuar;
- aksidentet e shkatuara nga shkelja e rregullave rrugore;
- përdorimi jashtë kushteve të përcaktuara.

Neni 21 Ndërprerja e kontratës/marrveshjes

1. Kontrata/marrveshja ndërpritet:
 - o me kërkesë të përdoruesit;
 - o nga operatori/enti në rast shkeljeje;

2. Operatori/enti ka të drejtë të bllokojë aksesin në rast abuzimi.

Neni 22

Mbrojtja e të dhënave

Të dhënat personale trajtohen në përputhje me legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale.

**KREU VIII
DISPOZITA SHITESË**

Neni 23

Aneksi 1 kontratës/marrveshjes

Aneksi i kontratës/marrveshjes tip që do të përdoret për dhënien me qira të biçikletave elektrike dhe është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje. Ky aneks është i formuluar në dy gjuhë, Shqip dhe Anglisht

Neni 24

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet zgjidhen:

- fillimisht me mirëkuptim;
- në mungesë marrëveshjeje, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

KREU IX

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 25

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli i Bashkisë dhe konfirmimit në Prefekturë.

Tipi/modeli i biçikletës

e-bike model TS, Product Description 4S Battery: 48 V 25 AH Motor. 48 V 750W



RREGULLORE E PËRDORIMIT TË BIÇIKLETAVE ELEKTRIKE BASHKIA PËRMET